

PËRMBLEDHJE PROJEKTI

Titulli:	DEVINPRO 2008/2010
	Forcimi i lidhjes ndërmjet migrimit dhe zhvillimit nëpërmjet krijimit dhe testimit të produkteve dhe shërbimeve të replikueshme që ndikojnë migrimin për migrantët dhe komunitetet e tyre
Kohëzgjatja:	20 muaj
Fillimi:	Nëndor 2008
Vendet:	Shqipëri, Kosovë, Evropë Perëndimore

Përshkrim i shkurtër i projektit

Projekti DEVINPRO po ndërmerret nga Iniciativa për Migrim dhe Zhvillim NEXUS (NEXUS) me mbështetjen e Qendrës për Studime Ekonomike dhe Sociale (QSES) dhe bashkëfinancohet nga Fondi Ndërkombëtar për Zhvillimin Bujqësor (IFAD) dhe Raiffeisen bank Shqipëri.

Projekti synon njohjen e migrantëve dhe të atyre që përfitojnë prej migrantëve, si një segment i veçantë i tregut. Projekti mbështet në mënyrë të drejtpërdrejtë objektivat personale të migrimit që migrantët dhe të afërmit e tyre kanë patur gjatë ciklit të tyre migrator, duke ofruar mundësitë e duhura lidhur me remitancat, kursimet dhe investimet. Në mënyrë që e gjithë eksperiencia e migrimit të jetë e suksesshme, të ardhurat, remitancat, transfertat e migrantëve dhe vijueshmëria e përfitimit të investimit të tyre do të maten në mënyrë pozitive.

Në të njejtën kohë projekti do të zgjerojë dhe thellojë ndërmjetësimin financiar, duke lehtësuar kështu sipërmarrjen dhe mundësitë e punësimit në vendet e originës. Me anë të këtyre dy mënyrave projekti lidh migrimin, remitancat dhe ndërmjetësimin financiar me zhvillimin e qëndrueshem.

Projekti, i cili do të implementohet në disa komunitete rurale të përzgjedhura në Shqipëri dhe Kosovë, përfshin 3 faza që ndërlidhen me njëra-tjetrën:

Faza I: Duke synuar të shërbejë si guidë për fazat e mëvonshme, kjo fazë do të vlerësojë kërkesën e tregut si dhe do të identifikojë produktet dhe shërbimet që janë relevante për migrantët. Matja (dhe evidentimi i pikave të mundshme të ndërhyrjes) do të përfshijë gjithë ciklin e migrimit (periudhën e para migrimit, migrimin dhe rikthimin) çka do të çojë në a) një analizë të plotë të komuniteteve të migrantëve si dhe b) në organizimin e një workshopi me specialistë nga partnerët dhe nga pala qeveritare.

Faza II: Zhvillimi i produkteve dhe shërbimeve inovative që lidhen me migrantët në bazë të analizës së tregut në bashkëpunim me partnerët e konsorciumit dhe me palën qeveritare.

Faza III: Të testojë dhe të monitorojë hedhjen e produkteve dhe shërbimeve të zgjedhura në treg; të vlerësojë impaktin e produkteve të testuara me synim zhvillimin e një modeli biznesi hartimin e rekomandimeve për qeverinë atje ku është e nevojshme

Kombinimi i njohurive egzistuese mbi tregun e punës i kuadreve regulluese ligjore dhe i njohurive mbi kapacitetet aktuale të degëve të bankës me ekspertizën mbi kreditimin bankar përbëjnë komponentët kryesorë të DEVINPRO. Ky konsorcium përbëhet nga 7 partnerë dhe nga NEXUS i cili luan rolin e iniciatorit dhe koordinatorit të projektit. Në vazhdim të kontributit thelbësor në ekspertizë nga secili pjesëmarrës, Banka Raiffeisen Shqipëri ka deklaruar se do të japë dhe fonde për bashkëfinancimin e projektit: Partnerët e projektit përfshijnë:

- Raiffeisen Bank Shqipëri
- Raiffeisen Bank Kosovë
- Credins Bank
- Tirana Bank
- Opportunity Albania
- Qendra për Studime Ekonomike dhe Sociale

Sfidat

Sfida e këtij projekti është maksimizimi i impaktit të migrimit në zhvillim duke identifikuar dhe testuar modele biznesi të replikueshëm dhe me vijueshmëri të cilat zgjerojnë kufijtë e sjelljes së remitancave, kursimeve dhe investimeve. DEVINPRO lidh migrimin dhe objektivat financiare me zhvillimin nëpërmjet:

- a) Zhvillimit dhe testimit në treg të opsioneve që kanë impakt të drejtpërdrejtë tek migrantët përsa i përket remitancave, kursimeve dhe investimeve duke i konsideruar migrantët si një segment i veçantë i tregut;
- b) Komplementimit të aktorëve publikë dhe privatë të përfshirë në negocimin financiar/dhënien e kredive; menaxhimin e migrimit, zhvillimin ekonomik të rajoneve të marxhinalizuara dhe zhvillimin e NMV-ve;
- c) Zgjerimit dhe thellimit të negocimit financiar nëpërmjet tërheqjes së transfertave të migrantëve drejt ndërmjetësimit financiar formal dhe investimeve produktive në Shqipëri dhe Kosovë.

Adresimi i këtyre sfidave është i rëndësishëm për:

- Mbështetjen e migrantëve që ata të arrijnë qëllimet e tyre financiare dhe objektivat e migrimit me anë të : a) të ardhurave më të larta; b) vlerësimit më lart të remitancave; c) akumulimit më të shpejtë dhe më të lartë të kursimeve.
- Kursimet e migrantëve përfaqësojnë një burim kryesor fondesh i cili me anë të produkteve të duhura financiare, incentivave të nevojshme, sigurisë dhe kuadrit rregullator përkatës , mund të orientohet në kursime, investime dhe mundësi sipërmarrëse.
- Impakti potencial që kapitali i migrantëve mund të ketë mbi zhvillimin rritet në mënyrë dramatike kur kjo lidhet me shërbimet financiare si kursimet, sigurimet dhe kreditë.
- Me maturimin e cikleve migratore shqiptare dhe kosovare nevojat imediate plotësohen dhe si rrjedhojë një pjesë më e madhe të ardhurash të fituara prej migrimit do të zhvendosen drejt kursimeve dhe investimeve në vendin pritë ose në vendin e origjinës.
- Kjo valë në zgjerim kursimesh do të ndodhë vetëm në një ambjent makro ekonomik dhe biznesi të përmirësuar, duke krijuar kështu më shumë mundësi për zhvillimin e biznesit.

Zonat e targetuara dhe Përfituesit

Në gjashtë komunitetet rurale në Shqipëri dhe Kosovë ku projekti do të pilotohet, grupet kryesore të targetuara nga DEVINPRO përfshijnë a) migrantët e përkohshëm, b) migrantët afatgjatë përfshirë dhe diasporën dhe, c) të punësuarit dhe sipërmarrësit në vendet e origjinës. Partnerët e konsorciumit janë të bindur se principet/produktet që do të zhvillohen, përpunohen dhe testohen në kontekstin e Shqipërisë e Kosovës do të aplikohen në vende të tjera kryesore të origjinës me qëllim shtimin e numrit të përfituesve të drejtpërdrejtë.

Komponentët dhe aktivitetet e projektit

- ✓ Të ndërmerë një analizë të plotë tregu për identifikimin e klientëve dhe përfituesve potencialë në komunitetet e migrantëve dhe vlerësimi i kërkesës së tregut për produkte dhe shërbime të cilat do të identifikohen duke përfshirë të gjithë ciklin e migrimit (para nisjes, migrimin dhe rikthimin).
- ✓ Zhvillimin i produkteve dhe shërbimeve premtuese dhe inovative bazuar në kriteret e theksuara më sipër.
- ✓ Testimi i produkteve dhe shërbimeve të përzgjedhura; monitorim dhe vlerësimi i impaktit të tyre; krijimi i modeleve të biznesit dhe dhënia e rekomandimeve partnerëve dhe palëve të interesuara mbi mekanizmat e ndërhyrjes që menaxhojnë migrimin, remitancat, kursimet dhe ambicjet për investim të migrantëve aktualë nga Shqipëria dhe Kosova.

Kontaktet

Skuadra e projektit DEVINPRO

Tel. +355 4 222 53 16

E-mail: DEVINPRO@nexus-mdi.org

Web: www.nexus-mdi.org